



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 29.10.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024 - 2028.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024 - 2028.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe sektorët të cilët duhet ta zbatojnë këtë plan.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-27726-2124

Dt. 29.10.2024



Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj

Arijeta Skeraj

PLANI I VEPRIMIT

Komuna e Dragashit

Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara

2024 – 2028



Të nderuar qytetarë të Komunës së Dragashit,

Me këtë Plan Komunal të Veprimit për Personat me Nevoja të Veçanta, shënojmë edhe një hap tjetër të rëndësishëm drejt përmbushjes së obligimeve tona ndaj një kategorie të ndjeshme të shoqërisë. Përmes një bashkëpunimi të shkëlqyer me Down Syndrome Kosova, mbështetur dhe financuar nga UNICEF-i, në bashkëpunim me USAID në Kosovë dhe Bashkimin Evropian, jemi angazhuar maksimalisht që ky Plan të përmbajë objektiva dhe aktivitete specifike, në mënyrë që çdo individ të ketë mundësinë për të jetuar dhe zhvilluar potencialin e tij në një mjedis të barabartë dhe gjithëpërfshirës.

Plani i Veprimit për Personat me Nevoja të Veçanta përfshin objektiva dhe veprime konkrete për të adresuar nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuar, duke e bërë Komunën e Dragashit një vend më të mirë për të gjithë qytetarët. Nëpërmjet këtij dokumenti, ne shprehim përkushtimin tonë për të promovuar drejtësinë sociale dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë për të gjithë.

Përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve të ndryshme, mund të bëjmë ndryshime të rëndësishme dhe të krijojmë ambiente që inkurajojnë përfshirjen dhe respektin ndaj diversitetit të njerëzve. Në këtë rrugëtim, angazhimi ynë është për të ndërtuar ura të forta dhe të qëndrueshme, për të siguruar që personat me nevoja të veçanta të kenë mundësi reale për të kontribuar në shoqërinë tonë në mënyra të ndryshme dhe të jenë pjesë e përparimeve të saj.

Me respekt,

Bexhet Xheladini

Kryetar i Komunës së Dragashit

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar.....	5
3. Buxheti.....	8
4. Plani i Aktiviteteve.....	9

Hyrje

Personat me aftësi të kufizuara (PAK), janë një numër të konsiderueshëm të qytetarëve në Komunën e Dragashit. Pavarësisht aftësive të tyre, ata kanë të drejta dhe nevoja për të cilat shoqëria, shteti dhe posaçërisht qeverisja lokale duhet që t'i përmbushin konform konventave dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Vetëm duke i zbatuar në plotni të gjitha këto obligime institucionale, personat me aftësi të kufizuara do të ndihen të vlerësuar, të barabartë dhe jo të diskriminuar në raport me qytetarët e tjerë.

Plani Komunal i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar është një dokument publik i rëndësishëm, i cili përshkruan konceptet se si Komuna do t'i qaset diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminim e kësaj kategorie të qytetarëve.

Planet e veprimit të aftësisë së kufizuar i asistojnë komunës që të njohë më mirë nevojat dhe prioritetet e personave me aftësi të kufizuara, si dhe i mundësojnë asaj të krijojë qasje më të lehtë për ta. Planet e veprimit për aftësinë e kufizuar e zvogëlojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar si dhe fokusimin e shpenzimeve në fusha të rëndësishme të lartë, duke klasifikuar prioritetet. Planet e veprimit për aftësinë e kufizuar janë dokumente formale me kërkesa të veçanta të identifikuar nga vetë përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara, të cilat bazohen në të drejtat e njeriut.

Plani aktual i Veprimit për periudhën 2024-2028 për Personat me Aftësi të Kufizuar është rezultat i punës së Down Syndrome Kosova në bashkëpunim me Zyrën e kryetarit të Komunës së Dragashit, mbështetur dhe financuar nga UNICEF-i në bashkëpunim me USAID-in në Kosovë. Grupi Punues ka realizuar punëtori të cilat kanë shërbyer si mundësi për të identifikuar problemet dhe për të gjetur zgjidhjet më të përshtatshme, bazuar në gjendjen aktuale të komunitetit me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Dragashit.

Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar

Para se të vazhdohet më tej, konsiderohet të shpjegohet terminologjia e personave me aftësi të kufizuar, në mënyrë që të gjitha palët e interesit të kuptojnë njëjtë terminologjinë e përdorur.

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara, si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi "person me handicap" është zëvendësuar me termin "Person me Aftësi të Kufizuara" (individualisht) dhe "Persona me Aftësi të Kufizuara" (në nivel shoqëror).

Që tani e tutje "Persona me Aftësi të Kufizuara" (PAK) janë ata persona tek të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.

Ky përcaktim, i cili i përmbahet propozimit të OBSH, nuk bazohet në mungesa reale apo të supozuara. Në qendër të vëmendjes vendoset pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Një ndryshim nga kushtet normale do të thotë humbje ose kufizime në lidhje me strukturat fizike, mendore apo psikologjike, të cilat janë të pranishme në moshën përkatëse.

Aftësia e Kufizuar ekziston në rast se dëmtimi çon në një kufizim, i cili ndikon në pjesëmarrjen në një ose disa fusha të jetës. Kriteri i zgjatjes prej gjashtë muajsh të kufizimit përjashton parregullsitë e përkohshme, të cilat nuk konsiderohen si aftësi e kufizuar, por nuk përjashton ndërhyrjet e menjëhershme që janë të nevojshme në rastet individuale për shmangien e saj. Kjo ka të bëjë në veçanti me fëmijët, tek të cilët është verifikuar aftësia e kufizuar apo rreziku i mundshëm i aftësisë së kufizuar.

Parimet Themelore

Ky dokument strategjik për të gjitha palët e interesit, si ato të organizatave të shoqërisë civile, ashtu edhe nga institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, duhet të udhëhiqet nga parimet e përgjithshme të së drejtës për të qenë pjesë e shoqërisë kosovare. Janë gjithsej shtatë parime në bazë të së cilave është hartuar dokumenti strategjik për PAK për Rajonin e Prizrenit.

Parimi i Së Drejtës Shoqërore, Barazisë dhe Mosdiskriminimit

Personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Kjo përfshin ndihmën sociale që i lejon personat me aftësi të kufizuara të jetojnë me dinjitet.

Parimi i Vetëvendosjes

Vjen nga përqasja me të drejtën shoqërore dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë të aftë të vendosin vetë. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale. Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me rehabilitimin duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuara. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë pa pëlqimin e tij/saj.

Parimi i Përfshirjes, Pjesëmarrjes dhe Mundësive të Barabarta

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë ku ata jetojnë, prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit e tjerë. Ata kanë përfitime që i lejojnë ata të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë

Ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen pa pengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuar pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

Parimet e Parandalimit, Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm

Ka të bëjë me një numër masash që ndërmerren për të evituar sa të jetë e mundur shfaqjen e aftësisë së kufizuar dhe sëmundjeve kronike në të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha fushat e jetës. Në këtë aspekt fusha me rëndësi janë mbrojtja e shëndetit, siguria në punë, parandalimi i aksidenteve dhe mbrojtja e mjedisit. Ky parim gjithashtu përfshin parandalimin e aftësisë së kufizuar përgjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet masave siç janë imunizimi etj. Kjo reflekton intuitën që sa më herët të identifikohet në fëmijëri një parregullsi, aq më i mirë dhe i shpejtë do të jetë parandalimi i aftësisë së kufizuar ose trajtimi i suksesshëm i saj. Kjo vlen për të gjitha grupmoshat.

Parimi i Rehabilitimit

Qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, mënjanimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit e saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuara.

Parimi i Qëllimshmërisë

Parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar dhe personave që kanë rrezik të bëhen të tillë, pavarësisht nga shkaku i aftësisë së tyre të kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

Buxheti

Kostoja e përgjithshme e strategjisë dhe Planit Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuar, për periudhën katër (5) vjeçare, është vlerësuar në 288,950.00 €. Periudha e zbatimit përfshin vitin 2024, vitin 2025, vitin 2026, vitin 2027 dhe vitin 2028 .

Për vitin 2024 janë planifikuar 15,000.00 €, për vitin 2025 janë planifikuar 70,450.00 € , për vitin 2026 janë planifikuar 74,000.00 € , për vitin 2027 janë planifikuar 80,000.00 € dhe për vitin 2028 janë planifikuar 49,500.00 €.

Buxheti i planifikuar për realizimin e secilës nga pesë objektivat e dokumentit strategjik për periudhën katërvjeçare është si vijon: për realizimin e objektivit të parë “Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuar” janë planifikuar gjithsej 158,000.00 €; për realizimin e objektivit të dytë “Përmirësimi i qasjes fizike në objekte publike” janë planifikuar gjithsej 18,850.00; për realizimin e objektivit të tretë “Përmirësimi i kushteve në institucionet edukativo-arsimore për gjithë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara” janë planifikuar gjithsej 102,100.00 €, dhe për objektivin e katërt ” Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës” janë planifikuar 9,500.00 €.

Meqenëse aktivitetet e planifikuara në këtë dokument strategjik synojnë të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe sektorin e biznesit, ekzistojnë mundësitë që një pjesë e kostos së këtij dokumenti strategjik të reduktohet, varësisht prej programeve dhe projekteve që i realizojnë organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe bizneset. Gjithashtu, nuk përjashtohen mundësitë e përkrahjes nga agjencionet, zhvillimore/donatorët e huaj, për t’i zbatuar masat e ndryshme të këtij dokumenti strategjik.

PLANI I AKTIVITETEVE

Objektiva 1	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuara.												
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit					Indikatorët	Buxheti				
			2024	2025	2026	2027	2028		2024	2025	2026	2027	2028
1.1 Janë evidentuar nevojat dhe personat me aftësi të kufizuara.	Krijimi i regjistrit të veçantë të personave me aftësi të kufizuara dhe identifikimi i nevojave të tyre. Janë realizuar Vizitat në teren për identifikimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara.	DSHMS dhe QPS.	X	X	X	X	X	Numri i personave të regjistruar		5000	1000	1000	1000
1.2 Ngritja e nivelit të vetëdijes mbi rëndësinë e statistikave për personat me aftësi të kufizuara.	Njoftimi dhe inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për diagnostifikim dhe regjistrim.	Down Syndrome Kosova dhe Komuna e Dragash-it.	X	X	X	X	X	Dizajnimi i Broshurës	200	200	200	200	200
1.3 Janë ngritur kapacitetet e grupit të vizitave në shtëpi për identifikim të hershëm të aftësisë së kufizuara.	Organizimi i trajnimeve për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuara.	Drejtoria përkatëse/OJQ	X	X	X	X	X	Numri i trajnimeve të organizuara Numri i personelit mjekësor të trajnuar		2000	500	500	500
1.4 Është krijuar grupi mobil multidisiplinar për ofrimin e shërbimeve për	Është Zhvilluar dhe Aprovuar rregullorja për ofrimin e shërbimit mobil	DSHMS	X	X	X	X	X	Numri i vizitave Numri i familjeve të vizituara	2,000	10,000	10,000	10,000	10,000

personat me aftësi të kufizuara	për personat me aftësi të kufizuara. Fuqizimi i mekanizmave për kontrollim dhe monitorim të institucione jo-publike të cilat ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara Janë krijuar 2 Grupe multidisciplinace mobile												
1.5 Është përmirësuar furnizimi i personave me aftësi të kufizuara me barna të nevojshme individuale.	Inicimi i ndryshimit të rregullores komunale për subvencionime. Rritja e shumës së subvencionimit të barnave të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.	DSHMS dhe QKMF	X					Shuma e lejuar e subvencionimit					
		DSHMS	X	X	X	X	X	Shuma e subvencionimit e caktuar me rregullore	2000	2000	2000	2000	
1.6 Janë përmirësuar shërbimet terapeutike dhe mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.	Kontraktimi i shërbimeve terapeutike dhe mbështetëse.	DSHMS dhe OJQ -te e licencuara për shërbime përkatëse	X	X	X	X	X	Numri i shërbimeve të kontraktuara	1000	25,000	35,000	35,000	
Objektiva 2		Përmirësimi i qasjes fizike në objekte publike											
Rezultatet	Aktivitetet						Viti i implementimit	Indikatorët		Buxheti			

		Institucioni përgjegjës	2024	2025	2026	2027	2028		2024	2025	2026	2027	2028
2.1 Është rregulluar qasja në tualete në hapësirat publike.	Rikonstruktimi i tualeteve në objektet e Administratës komunale, shkolla, QKMF, QMF dhe AMF të Komunës së Dragashit.	Drejtoria e Urbanizmit	X	X	X	X	X	Numri i tualeteve të rregulluara	1500	2000	2000	2000	2500
2.2 Rregullimi i shenjzimit të parkingjeve në vendet publike.	Shenjzimi i parkingjeve shtesë në objektet e institucioneve publike lokale.	Drejtoria e Urbanizmit	X	X	X	X	X	Numri i parkingjeve të shenjzuara	500	750	1000	1200	1200
2.3 Rregullimi i pllakave taktile apo pllaka për orientim të personave të verbër.	Vendosja e pllakave taktile apo pllaka për orientim të personave të verbër në hapësirat publike.	Drejtoria e Urbanizmit	X	X	X	X	X	Numri i pllakave taktile të vendosura.	1500	800	1500	200	200
Objektiva 3		Përmirësimi i kushteve në institucionet edukativo-arsimore për gjithë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara											
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit					Indikatorët	Buxheti				
			2024	2025	2026	2027	2028		2024	2025	2026	2027	2028
3.1 Janë vlerësuar fëmijët në aspektin pedagogjik	Funksionalizimi i ekipit vlerësues pedagogjik		X	X	X	X	X	Vendimi për emërimin e anëtarëve të Ekipit Vlerësues Pedagogjik					

3.2 Janë ngritur kapacitetet e Ekipit Vlerësues Komunal.	Organizimi i trajnimeve për anëtarët e ekipit vlerësues komunal dhe këmbimi i përvojave me ekipet tjera komunale	DKA / OJQ	X	X	X	X	X	Numri i trajnimeve të mbajtura. Numri i takimeve me ekipet tjera komunale		2000	1000	1000	1000
3.3 Është përmirësuar furnizimi me mjete didaktike për fëmijë me nevoja të veçanta në arsim	Planifikimi i buxhetit për mjete didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim.	DKA dhe Asistenti/ja për fëmijë	X	X	X	X	X	Kontrata kornizë	2,000	2,000	2,000	2,000	2000
3.4 Është rritur numri i asistentëve në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara	Planifikimi i buxhetit për punësimin e 10 asistentëve në shkolla dhe shpërndarjes proporcionale të tyre, sipas nevojave të fëmijëve dhe shkollave.	DKA/ Komuna	X	X	X	X	X	Shuma e buxhetit të planifikuar	00000	12000	12000	18000	24000
3.5 Është rritur organizimi i aktiviteteve rekreative për fëmijë me aftësi të kufizuara.	Planifikimi i buxhetit për mbështetje të aktiviteteve rekreative me fëmijë, të organizuara nga OJQ-të që punojnë me persona me aftësi të kufizuara.	DKA / DKRS / OJQ	X	X	X	X	X	Numri i aktiviteteve të organizuara	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
	Organizimi i aktiviteteve për shënimin e ditëve të veçanta	DKA / DKRS / OJQ	X	X	X		X	Numri i aktiviteteve të organizuara	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
3.6 Janë organizuar fushata vetëdijesuese për popullatën për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në	Publikimi i materialeve vetëdijesuese në mediat sociale, mediat lokale	Drejtoria e Arsimit	X	X	X	X	X	Numri i thirrjeve publike	100	1,500	1,500	1,500	1,500

Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit					Indikatorët	Buxheti																				
			2024	2025	2026	2027	2028		2024	2025	2026	2027	2028																
sistemin e rregullt edukativ.													Numri i klikimeve në publikime																
Objektiva 4													Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës																
4.1 Janë evidentuar personat me aftësi të kufizuara të moshës madhore													Azhurimi i databazës		Drejtoritë përkatëse		X	X	X	X	X	Databaza e krijuar.		1000		1000			
Angazhimi i zyrës komunale për punësim në njoftimin e personave me aftësi të kufizuara për aftësim dhe riaftësimin.													Zyra për punësimin, Komunal		X	X	X	X	X	Numri i personave me aftësi të kufizuara të kontaktuar nga zyra për punësim		200		200		200			
Krijimi i Mekanizave financiar komunal për aftësim dhe riaftësim profesional QAP													Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave		X	X	X	X	X	Mbulimi i shpenzimeve		1000		1000		100		1200	
Plotësim i kuotës së punësimit dhe punës praktike të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik													Zyra e kryetarit dhe kabineti.		X	X	X	X	X	Numri i institucioneve									

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragash

ON Nr. Br. 060/01-27726-2/24
23.10 20 24
 Dragash - Dragash

Kryesuesja e Kuvendit
 Arijeta Skeraj

